



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit
dhe të Drejtave të Njeriut



Fushë-Arrëz, më 19.12.2024

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 33 datë 26/11/2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxhetin Vjetor per vitin 2025"

Analiza ligjore: Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2025-2027 është bere bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin 68/2017 date 27.4.2017 " Per financat e veteqeverisjes vendore ", udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 23 date 30.07.2018 "Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV", udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë "Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027", dhe anekset plotësuese.

Hartimi i Buxhetit për vitet 2025 - 2027 është kryer pas një pune gjithëpërfshirëse të administratës së Bashkisë, anëtareve të Këshillit të Bashkisë, Njësise Administrative, komunitetin e biznesit, komunitetin e banoreve, si dhe aktore të ndryshëm të shoqërisë civile. Përgatitja e buxhetit është paraprirë nga dëgjesa dhe komunikim me publikun, Promovimi i transparencës në krijimin e instrumenteve financiarë ndaj komunitetit përbën një detyrim ligjor për organet shtetërore, por në fakt është edhe një detyrim moral që kanë institucionet e qeverisjes vendore ndaj komunitetit që përfaqësojnë. Hartimi i Buxhetit u përfshi në një cikël të plotë buxhetimi sipas kërkesave ligjore, duke i ndjekur të gjitha hapat të përcaktuara në ligj. Administrata e Bashkisë është bazuar kryesisht

ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe ligjin nr.146/2014 "Për konsultimin publik", përveç akteve ligjore dhe nënligjore teknike dhe specifike të sipërcituara të domosdoshëm për hartimin e këtij instrumenti financiar.

Situata aktuale e funksionit: Përmes fondeve të alokuara në këtë program buxhetor, synohet bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për uljen e varfërisë. Në këtë drejtim bashkia ka punuar gjatë vitit në objektiva si: Ofrimi i sigurisë dhe garantimi i kushteve optimale për rritjen e fëmijëve 0-3 vjeç në çerdhe, Sistem i kujdesit social për personat e sëmurë dhe PAK efikas, Mbështetja e edukimit dhe formimit profesional për të siguruar uljen e nivelit të papunësisë nëpërmj. Buxheti i alokuar në këtë program buxhetor është përdorur nga bashkia për përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen komunitetit për kujdesin social.

Situata financiare : Bashkia Fushë Arrëz ka ndjekur te gjithë fazat e hartimit te buxhetit sipas afateve te percaktuara në udhezimin perkates.

Buxheti për Programi Përkujdesi Social per vitin 2025 do te jete në shumen 5.479.000 lek.

Ka një rritje të shpenzimeve për pagat e personelit me 1.281.000 për të reflektuar ndryshimet ligjore të vitit të fundit për rritjen e pagave të administrates. Numri i punonjesve për këtë program nuk do te kete ndryshim.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Çështjeve Sociale ka relatuar përpara komisionit për Projekt Buxhetin 2025

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjimore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave te Njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Financës ose Drejtoria e Çështjeve Sociale për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Programi Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor per vitin 2025 impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Janë mbajtur dëgjesat publike në Fushë Arrëz, në Njësitë Administrative Qafë Mali, Iballë, Fierzë dhe Blerim me banorët e të gjitha Njërive Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe Ndërlidhësit Komunitarë, përfaqësues të grupeve të ndryshme te interesit, etj.

Dëgjesat janë mbajtur sipas kalendarit të dëgjesave të publikuar në rregjistrin e konsultimeve me publikun. Është publikuar edhe përmbledhja e rekomandimeve të qytetarëve.

Numri i pjesëmarrësve në konsultime ishte 108 persona, nga të cilët 32 gra dhe vajza (20%) dhe numri i rekomandimeve ishte 54.

Komisioni i i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjimore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave te Njeriut , i mbledhur me datën 19.12.2024, shqyrtoi projekt vendimit nr.33 datë 26/12/2024, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxhetin Vjetor per vitin 2025 " paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në
proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Terence Demo Jenu

Datë 19.12 2024